



Dalës-Izlasza

Nr. 11-894

Data 11.08.2020

Datum


OBILIQ-OBILIĆ

Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova



Komuna e Obiliqit - Opština Obilić - Municipality Obiliq

Datë/Data/Date	11/08/2020
Nga/Od/From:	z. Xhafer Gashi, Kryetari i Komunës së Obiliqit
Për/Za/To:	z. Burim Gërguri, Kryesuesin e Kuvendit Komunal - Obiliq
Tema/Subjekat/Subjeckt:	Raporti i Punës së Kryetarit - Janar-Qershor 2020



I nderuar,

Duke u bazuar në ligjet në fuqi, Statusin dhe rregulloret e punës në komunën e Obiliqit që e parashohin edhe raportimin në kuvend të punëve të përfunduara dhe atyre që janë filluar apo janë në proces të përfundimi. Ju lutem Pranoni Raportin Janar-Qershor2020 të Punës së Kryetarit të Komunës dhe Ekzekutivit.

Me respekt,



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova



Komuna e Obiliqit - Opština Obilić - Municipality Obiliq

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare nr. 28 te dt. 04.06.2008), nenit 73 të Statutit të Komunës, neni 72 pika 1.7 e statutit të Komunës së Obiliqit Nr. I-34 të datës 25.04.2016 Kryetari i komunës raporton për punët e përfunduara gjatë për vitin 2020.

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS - JANAR - QERSHOR - 2020

Obiliq, 2020

PËRMBAJTJA

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS.....	1
RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS	2
RAPORTI I PUNËS – DREJTOTRIA E ADMINISTRATËS.....	5
RAPORTI I PUNËS – DREJTOTRIA E ARSIMIT.....	7
RAPORTI I PUNËS – DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS.....	13
RAPORTI I PUNËS – DREJTORIA E SHËNDETËSIS DHE MIRQENIES SOCIALE	20
RAPORTI I PUNËS – DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE MJEDIS.....	56
RAPORTI I PUNËS – DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENTE.....	58
RAPORTI I PUNËS – DREJTORIA E INSPEKSIONIT.....	62
RAPORTI I PUNËS – DREJTORIA E URBANIZMIT	66
RAPORTI I PUNËS – DREJTORIA PËR KULTUR RINI DHE SPORT	72
NJËSIA E BURIMEVE NJERËZORE.....	74
RAPORTI I PUNËS – DREJTORIA E FINANCAVE	79
RAPORTI I PUNËS ZYRA E PROKURIMIT.....	.00
RAPORTI I PUNËS ZKKK-SË.....	.00

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS

• Raporti i Punës Janar – Qershor 2020

FJALA E KRYETARIT

I nderuar Kryesues i Kuvendit, të nderuar asambleistë të Kuvendit Komunal, drejtorë, përfaqësues së institucioneve të Komunës, shoqërisë civile dhe mediave.

Kam kënaqësinë të paraqes para jush raportin gjashtëmujorë për punët, angazhimet, të arriturat, dhe vështirësitë më të cilat është përballur Komuna e Obiliqit gjatë kësaj periudhe kohore. Ky gjashtëmujorë, është shoqëruar me sfidën në ballafaqimin me pandeminë globale Covid-19, por, përkushtimi dhe vullneti ynë i dëshmuar prej vitesh, me të njëjtin ritëm po vazhdon edhe në këtë vit, në realizimin e synimeve dhe projekteve tona të përbashkëta në shërbim të qytetarëve të komunës së Obiliqit.

Gjatë kësaj periudhe, jemi angazhuar fuqishëm në rritjen e transparencës komunale dhe ofrimin e shërbimeve sa më të shpejta dhe efikase për qytetarët e Obiliqit. Me fillim viti, me drejtorët e drejtorive komunale, jemi fokusuar në përcaktimin e prioriteteve për realizimin e projekteve dhe investimeve kapitale për vitin 2020, duke marrë parasysh kërkesat dhe nevojat e qytetarëve të Obiliqit nga takimet e rregullta që kam zhvilluar me ta.

Menjëhere pas shfaqjes së rasteve të para me pandeminë globale Covid-19, Komuna e Obiliqit më 13 mars 2020, ka formuar Shtabin Emergjent Lokal, në funksion të parandalimit dhe menaxhimit të situatës me Covid-19. Si shef i shtabit emergjent lokal, njëherit zv.Kryetar i AKK-së, në koordinim të plotë më gjithë akterët institucional brenda shtabit, Qeverinë e Republikës së Kosovës, ministritë përkatëse dhe institucionet shëndetësore, kemi treguar përkushtim në respektimin e masave dhe rekomandimeve të dalura nga këto institucione, në të njëjtën kohë shprehi falënderimin dhe mirënjohjen time për të gjithë qytetarët e Obiliqit, për vetëdijen e lartë qytetare të treguar gjatë kësaj periudhe kohore.

Me qëllim të mbrojtjes së shëndetit dhe jetës së qytetarëve të Obiliqit, kemi funksionalizuar Qendren Operative Emergjente në funksion 24 orë për të gjithë qytetarët, kemi vendosur portat dezinfektuese në qendër të qytetit dhe në oborrin e QKMF-së, kemi zhvilluar procesin e dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit në të gjitha institucionet publike të komunës së Obiliqit, në banesat kolektive në fshatin Plemetin dhe në hyrjet/daljet e të gjitha ndërtesave në Obiliq. Situata me pandeminë globale Covid-19, ishte me e vështirësuar për familjet në nevojë të komunës së Obiliqit, me këtë rast me aprovimin e antarëve të shtabit emergjent komunal dhe aprovimin e asamblesë komunale në mënyra unanime, kemi ndarë shumën prej 100,000.00€, për shpërndarjen e pakove ushqimore në vlerë prej 50€ të dedikuara për këto familje, si dhe një pjesë e këtyre mjeteve është ndarë për dezinfektimin e objekteve dhe mjete mbrojtëse në sektorin e shëndetësisë. Përveç familjeve në nevojë, ekipet e shtabit emergjent lokal, kanë ofruar përkrahje me pako ushqimore, higjienike dhe me listën e barnave varësisht nga kërkesat dhe rekomandimet e profesionistëve shëndetësorë, për pacientët të infektuar me virusin Covid-19, të cilët janë në vet-izolim.

Përkrahja në tejkalimin e kësaj gjendjeje, nuk ka munguar nga organizatat e ndryshme jo-qeveritare, nga shoqatat bamirëse, diaspora shqiptare dhe vullnetëmirët, për të cilët shpreh falënderimin tim dhe gjithë institucionit komunal, kjo mbështetje është dëshmi se vetëm të bashkuar mund të dalim fitues në çdo situatë.

Gjatë këtij gjashtëmujori, me ftesë nga shefja e zyrës së BE-së në Kosovë, znj.Natalya Apostolova, kam marrë pjesë në prezantimin e projektit “Green Deal”, një projekt në vlerë prej 76 milionë €, që parasheh renovimin e Termocentralit “Kosova B”, takim me përfaqësues nga Banka Botërore në realizimin e projektit për shëndrrimin e tokave të kontaminuara në hapësira të gjelbërta. Gjatë muajit shkurt, me kolegë kryetar komunash, përfaqësues nga AZHR-ja, Oda Ekonomike Amerikane dhe me stafin e Konsullatës së Kosovës në Ioëa, kam zhvilluar takime të rëndësishme me përfaqësues të komunave të shtetit të Ioëa-s, ku temë diskutimi ishte kryesisht zgjerimi i bashkëpunimit mes qyteteve të shtetit të Ioëa-s, në fushën e ekonomisë dhe mundësinë të investimeve në komunën e Obiliqit nga kompanitë amerikane të këtij shtetit. Duke respektuar gjithmonë rregullat dhe rekomandimet e IKSHPK-së, kam zhvilluar takimet të rëndësishme me institucionet qendrore, ku temë diskutimi kryesisht ishte menaxhimi i situatës me Covid-19 në komunën e Obiliqit, funksionimi i shtabit emergjent lokal, nevoja e thellimit të bashkëpunimit me nivelin qendror me qëllim të parandalimit dhe luftimit të këtij armiku të padukshëm, duke pritur kështu në vizitë ish-Kryeministrin z.Albin Kurti, zv.Ministrin e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike z.Bajram Gecaj, ish-Ministrin e Shëndetësisë z.Arben Vitia. Në cilësinë e zv.Kryetarit të AKK-së, takime virtual me kolegët kryetar komunash, kemi zhvilluar me Kryeministrin e Republikës së Kosovës, z.Avdullah Hoti, Ministrin e Shëndetësisë z.Armend Zemaj, drejtorin e AKK-së z.Sazan Ibrahim. Kam pritur në vizitë, Kryetaren e Kuvendit të Republikës së Kosovës, znj.Vjosa Osmani me deputetet e Kuvendit të Kosovës; z.Liburn Aliu, znj.Albena Reshitaj, znj.Mimoza Kusari-Lila, avokatin e popullit z.Hilmi Jashari, ku së bashku me të rinjtë e Obiliqit, kemi diskutuar për sfidat mjedisore dhe ndikimi i tyre në shëndet, si dhe Ligjin për Obiliqin, plotësimin e këtij ligji me aktet nënligjore. Tema të rëndësishme të kësaj natyre kam diskutuar edhe në takimet e zhvilluara me zv/Kryeministrin e parë të Rep. së Kosovës , z.Besnik Tahiri, me Ministrin e MEA-së, z.Blerim Kuçi, prej të cilëve morra mbështetjen se të gjitha shqetësimet dhe kërkesat e qytetarëve të Obiliqit, do të trajtohen me prioritet duke u bazuar në ligjet dhe rregulloret në fuqi.Po ashtu, kam zhvilluar takime të rregullta pune, me KFOR-in, OJQ-të, drejtorët e institucioneve arsimore, përfaqësues të OBSH-së, Qendrën Rinore.

Përkundër pandemisë, ne, njëkohësisht jemi angazhuar në implementimin e projekteve dhe investimeve kapitale në çdo lagje, lokalitet e fshat të komunës së Obiliqit, energjia dhe vullneti ynë i pandalshëm është kthyer në punë dhe përkushtim, duke përmbushur misionin tonë të shenjtë, atë të shërbimit të qytetarëve të Obiliqit.

Gjatë kësaj periudhe, kemi filluar realizimin e projekte të rëndësishme, kemi vazhduar punimet në projektet të cilat janë në proces, si dhe kemi nënshkruar marrëveshje të shumta bashkëpunimi:

Në sektorin e shëndetësisë, përpos përkushtimit të plotë në menaxhimin e situatës me Covid-19, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me organizatën humanitare “Duart e Bamirësisë”, kemi filluar ndërtimin e Ambulantës së Mjekësisë Familjare(AMF-së) në fshatin Breznicë, donacion nga organizata Zakat House e shtetit të Kuvajtit. Kemi nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me organizatën ASB-në (Arbeiter Samariter Bund) për mbështetjen e 20 familjeve në nevojë për krijimin e kushteve më të mira për fillimin e një biznesi të vogël familjar. Nënshkruam memorandum me shoqatën shumanitare “Jetimat e Ballkanit” për ndërtimin e 20 shtëpive për rastet sociale, vlera e këtij memorandum është 400,000.00€, ku komuna do të bashkëfinancojë në vlerë prej 100.000.00€, ndërsa shoqata në vlerë 300,000.00€. Në kuadër të subvencioneve të DSHMS-së, kam nënshkruar vendimin përmes secilit, çdo grua lehonë e komunës së Obiliqit do të i ndahet një shumë prej 150.00€, jam i përkushtuar që çdo kategori e

shoqërisë sonë të këtë përkrahjen e nevojshme institucionale, sidomos për gratë që janë shtylla kryesore e familjes dhe shtetit.

Në sektorin e arsimit, si rrjedhojë e situatës me pandeminë Covid-19, qysh në muajin mars u ndërpreh procesi i rregullt mësimor duke u zëvendësuar me atë virtual (online) për të cilin është bërë raportim i rregullt nga ana e drejtorisë së arsimit. Në kuadër të investimeve kapitale, filluam ndërtimin e aneksit shkollor të SHFMU “Ibrahim Rugova” në Mazgitin e epërm, me plan dinamikë 100 ditë punë, ky projekt tregon prioritetin tonë të vazhdueshëm në ngritjen e cilësisë në arsim dhe krijimin e kushteve sa më të përshtatshme për zhvillimin e mësimin për nxënësit dhe mësimdhënësit. Në Obiliq, fillojë ndërtimi i Bibliotekës së Qytetit, një hapësirë e cila ofron mundësi të gjitha grupmoshave që të kalojnë kohën e lirë nëpërmjet leximit, mbi të gjitha ky projekt ju dedikohet studentëve, të rinjëve dhe të rejave në avancimin e tyre intelektual, që në të ardhmen e afërt me idetë dhe kreativitetin e tyre të kontribuojnë për të mirën e qytetit tonë.

Mbrojtja e ambientit përmes mirëmbajtjes së parqeve ekzistuese, hapësirave publike dhe trotuareve, ne, jemi angazhuar edhe në rritjen e hapësirave të reja gjelbëruese, kemi nënshkruar memorandum bashkëpunimi me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal për bashkëfinancimin e projektit “Parku te Lagjja e Morinëve” në fshatin Mazgit i poshtëm, vlera totale e projektit është 182,627.32€, nga MZHR-ja ky projekt financohet në shumë prej 90,000.00€, ndërsa pjesa tjetër nga komuna. Me Korporatën Energjitime të Kosovës, me u.d drejtorin ekzekutiv z.Luigj Imeri, pas takimeve dhe konsultimeve të përbashkëta, nënshkruam memorandum bashkëpunimi për hartimin e projektit ideorë në realizimin e fazës së parë të projektit “Gjelbërojmë Tokën për Ardhmerinë- Parku i qetë” në fshatin Dardhishtë, ky projekt do të financohet nga Banka Botërore dhe vlera e tij parashihet të jetë nga 6 deri në 8 milionë dollare, përmes këtij memorandumi komuna e jonë do bëjë hartimin e projektit ideorë, ndërsa KEK-u do bëjë mostrimin dhe analizimin e tokës dhe ujërave në zonen e projektit. Përmes programit JICA(Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtarë), në sheshin “Aziz Zhilivoda” në Obiliq, është aktivizuar ekrani mobil për matjen e cilësisë së ajrit, përmes tij qytetarët do kenë mundësi të njoftohen për cilësinë e ajrit dhe nivelin e ndotjes në kohë reale.

Në kuadër të projekteve kapitale, kompletimi i kushteve të jetësës për qytetarët parasheh kompletimin e infrastrukturës rrugore dhe asaj nëntokësore, me këtë rast gjatë kësaj periudhe me asfaltim janë kompletuar shumë rrugë në fshatin Milloshevë, Raskovë, në qytetin e Obiliqit dhe shumë shpejtë pritet përfundimi i rrugëve në lokalitetet tjera, të parapara sipas drejtorisë së Infrastrukturës Lokale. Me përkushtim kemi punuar në rritjen e nivelit të sigurisë së qytetarëve të Obiliqit, në secilen lagje e fshat të Obiliqit. Është bërë shtrirja e rrjetit të ndriçimit publik në rrugët; “Avni Rrustemi”, “Luigj Gurakuqi”, “Ali Pasha”, “Graboci”, “Përvetica”, “Dukagjini” dhe “Aziz Zhilivoda” përgjatë rrugës Obiliq-Milloshevë, për të vazhduar me fshatin Palaj, Lajthishtë, Obiliqin e Vjetër, Plemetin, Siboc, Hade dhe Dardhishtë. Po ashtu, në bashkëfinancim me MAPL-në, shtrirja e rrjetit të ndriçimit publik është bërë edhe në rrugën “Llapi” përkatësisht rruga Obiliq-Milloshevë. Realizuar projektin e sinjalizimit horizontal dhe vertikal në qytetin e Obiliqit, duke ngritur sigurinë në komunikacion. Kemi nënshkruar marrëveshje për bashkëfinancim me AKK-në (Asociacionin e Komunave të Kosovës) për realizimin e projektit “Implementimi i sistemit solar fotovalik “on grid” me kapacitet (15.81 kËp), përmes organizatës SEEK kemi nënshkruar memorandum bashkëpunimi për projektin “Subvencionet për Efijencë të Energjisë në Kosovë” që zbatohet nga Fondacioni Mijëvjeçarë i Kosovës (MFK) dhe ka për qëllim të zvogëloj konsumin e energjisë elektrike në sektorin e banimit, me prioritet qytetarët me asistencë sociale.

Obiliqi, tashmë ka marrë pamje krejtësisht ndryshe, për të cilën secili qytetarë ka ëndërruar, ne, kemi zhvilluar procesin e rrënimt të objekteve të vetmisë dhe objektit të ish-restaurantit të KEK-ut, duke hapur kështu rrugë për investime të reja, në ndërtimin e sheshit “Adem Preniqi” dhe në rritjen e hapësirave gjelbëruese. Me intensitet dhe dinamikë të shtuar, po punohet në përfundimin e punimeve në sheshin “Dëshmorët e Kombit”, ku plani dinamik i këtij projekti pritet të përfundoj me 19 tetor 2020.

Situata e vështirësuar me pandeminë, ka krijuar edhe sfida në zhvillimin e projekteve, por, përkushtimi ynë nuk do të mungojë për të realizuar më të mirën për qytetarët e sidomos për ardhmërinë e fëmijëve tanë. Ka shumë punë në projektet që realizohen, gjithashtu ka nevojë për bashkëpunimin dhe angazhimin tonë të përbashkët në realizimin e projekteve të rëndësishme dhe të vlershme për qytetarët e Obiliqit. Duke falënderuar secilin prej jush për kontributin e vazhdueshëm, ju ftoj që të jemi unik në shërbim të komunitetit dhe qytetarëve!

RAPORTI I PUNËS – DREJTORIA E ADMINISTRATËS

• Raporti i Punës Janar – Qershor 2020

Me rastin e paraqitjes së pandemis COVID-19, në komunën tonë prej 16 marsit 2020 e deri me sot, jemi duke punuar me stafe të reduktuar dhe duke ju dhënë përgjigje të gjitha kërkesave të qytetarëve.

Drejtorja e administratës në kuadër të kompetencave të saj, po kryen punët dhe shërbimet administrative për qytetarët e komunës sonë.

-Sektori i Administratës së Përgjithëshme

Sektori kryen të gjitha punët profesionale, juridike të Kuvendit dhe Komiteteve obligative dhe mbikëqyrë punët në QSHQ.

- përgatit të gjitha vendimet sipas kërkesës së Kryetarit të Komunës, prokurimit dhe njërive kërkuese.
 - Përgjigja në të gjitha kërkesat e qytetarëve drejtuar kryetarit, bordit të drejtorëve, po ashtu lëshojmë vërtetime për qëndrim në Kosovë për qytetarët e diasporës, gjithsejtë janë lëshuar 3 vërtetime.
 - Kuvendi Komunal ka mbajtur - 4 -mbledhje të rregullta, 2- të jashtëzakonshme, 1- mbledhje urgjente (25 -vendime)
 - Komitetit për Politik dhe Financa- 4 mbledhje të rregullta,
 - Komitetit për Komunitete- 5 mbledhje të rregullta
 - Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) ka mbajtur - 2 mbledhje.
 - Komisionit për Performancën e komunës- për vitin 2019, ka dërguar në MAPL materialin e plotësuar me 30 qershor 2020.
- kemi pasur 3 kërkesa për qasje në dokumentet publike – zyrtare të aprovuara.
 - përkthimi shqip-serbisht dhe anasjelltas i të gjitha materialeve për KK-se dhe komiteteve obligative, rregulloreve, vendimeve dhe materialeve tjera sipas kërkesës së drejtorive.

- Pranimi dhe evidenca e saktë për mallin e pranuar dhe për mallin e shpërndan si dhe futjen e të dhënave në friballanc.

Arkivi

- Zyra e arkivës (shkrimorja) e komunës mbahet në mënyrë elektronike-manuale, ne këtë periudhe janë proceduar – 3.425 lëndë.
- Ekspeditivi i postës te lëndëve jashtë komunës-për institucione tjera përmes postës - 166 lëndë.
- lëndë te postes për institucionin e komunës-140 lëndë dhe 28- saktësime.

Zyra për Shërbime për qytetarët

- Punët e përditshme në pranim-dorëzimin e kërkesave të qytetarëve dhënia e informacioneve qytetarëve, ndihma dhe këshillat e nevojshme për realizimin e kërkesave dhe ankesave të tyre,
- Këto punë (lëndë) kryhen përmes intranetit dhe librave përkatëse, për periudhën raportuese, janë:
- te miratuara **9.859** lëndë,
- te refuzuara- **568** lëndë,
- në proces- **1007** lëndë,
- te pezulluara-**97**
- te anuluar-**84** lëndë,
- Gjithsejtë - 11.615 lëndë,**

Zyra e ofiqarisë

janë dorëzuar:

Ekstrakt lindjes	5,357
Certifikata të lindjes	1,288
Certifikata te martesës	1,184
Certifikata te vdekjes	274
Certifikata te vendbanimit	149
Certifikata e bashkësisë familjare	1,012
Certifikata e gjendjes martesore	164
Certifikata e shtetësisë	33
Vërtetim nga arkiva	56
Gjithsejtë	9,517

Numri i qytetareve qe kane kaluar ne regjistrin qendror	177
---	-----

Zyrtari i IT

Gjate kësaj periudhë në sektorin e IT janë ber 30 formatizimi formatizime dhe janë ber intervenime tek institucionet komunale shëndetësi arsim si dhe shkollat e komunës si dhe janë ber shumë punë tjera duke përfshirë krijimin në SIMBNJ 60 kyçje ne sitëm dhe 92 qasje në HRM SYSTEM .

Nga lëmi e servisimit të pajisjeve të IT janë servisuar shumë pajisje duke pasur problem me rrym dhe kanë shkaktuar dëme në pajisje të IT-së janë djegur 10 Poëer suplai (pajisje të furnizimit me rrym) dhe janë përforcuar 11 pc me ram memorie pasi që na është dashur të kalojmë nga sistemet e vjetruara ne të avancuara.nga Eëindoës 7 në ata Eëindoës 10 pasi qe kemi pasur rekomandim nga Ministria e Administratës Publike – ASHI .

Janë ber incizimet e mbledhjeve të kuvendit si dhe transmetimi drejt përderej me teleprezenc në MAPL dhe kam ber edhe kyçjani ne CMS ,

Çdo aktivitet që ka pas komuna kam qen i angazhuar me zërmi tu u nisur nga 17 shkurti e deri përmbylljen e festave të qershorit dhe aktivitete në Komunën ton .

Vlen të ceket se kemi probleme me pajisje të IT - Kompjuter – Llaptop pasi që janë te vjetruar dhe tani për kalimin nga Ëindoës 7 në Ëindoës 10 do kemi vështërsi pasi që performancat e kompjuterëve që kemi nuk mundën ti përballoja.

Aplikacionet komunale:

1. Intranet
2. E-arkiva
3. E-pasuria
4. Simbnj
5. SMVP
6. Domenin Mun.Gov.irk.rks
7. CMS
8. Free Balancë Ëeb Aplikacion
9. Sistemin e MPB për riatdhesim
10. Softëerin për Përkthim donacion nga USAIDI
11. Menaxhimin e të dhënave personale i caktuar nga ASHMDHP (MPB) gjithsej 3 raste
12. Menaxhimin e softuerit për Hapjen dhe caktimin e orarit të dyerve për hyrje dhe dalje

Ndërsa në QKMF menaxhimin e SISH Aplikacionit

Në Arsim kemi E-Shkollën i cili është duke u bërë analiza për fillimin dhe implementimin nga MASHT, ne kemi qenë në fazën e testeve dhe a mundemi të fillojmë implementimin e tyre ,

Në përdhën e reduktimit të stafit kam qenë për 90 ditë - menaxher për identifikimin e rasteve me nevojë për pako Ushqimore dhe shpërndarja e tyre -1200 pako janë shpërndarë nga komuna

Njësia për të Drejtat e Njeriut

- Takim me perf. të OSC-es , OJQ “Shtëpia e Shpresës” , Vizitë në Qendrën për Promovimin e të Drejtave të Grave në Drenas, Pjesëmarrja në cilësinë e panelistes në debat me të rinjtë shqiptar dhe serb për përdorimin e dy gjuhësisë organizuar nga OJQ Qendra Rinore.
- Takim i rregull i Grupit të Grave, Grumbullimi i të dhënave gjinore në shkollat e komunës sonë, Pjesëmarrja në takim të rregullt në Agjensionin për Barazi Gjinore(ZKM), me perf. të grave Bletare, me kryetarin GG dhe gratë në biznes, etj.
- Monitorimi i seancës së Kuvendit Komunal, KPF, K. Komunitete dhe KKSB.

Objektivi i DAP-së- për pjesën e dytë të vitit/2020- ka mbetur ndërtimi i objektit të arkivës (procedurat e prokurimit kanë përfunduar) dhe rregullimi i sallës së kuvendit me inventarë të ri dhe zërim.

RAPORTI I PUNËS – DREJTORIA E ARSIMIT

• Raporti i Punës Janar – Qershor 2020

DA, dinamikën e aktiviteteve dhe angazhimeve, e ka planifikuar konform Planit vjetor të punës së DA-së për vitin 2020, përkatësisht prioritet në DKA është *ngritja e cilësisë në mësimdhënie dhe të nxënimit si synimin* parësor, duke mos lënë anash edhe përmirësimin e kushteve tjera e posaçërisht të infrastrukturës shkollore, ku do të vije në shprehje mësimdhënia dhe mësim nxënia sipas kritereve avancuese të shkollave moderne.

Plani i punës i DA-së është specifik sa i takon aspektit kohor, viti shkollor përkatësisht ai mësimor nuk përputhen me vitin kalendarik, përkatësisht viti shkollor fillon në shtator të vitit paraparak, në këtë rast

raporti i gjashtëmujorit të parë (janar- qershor)2020, në arsim përfshinë raportin e gjysmë vjetorit të dytë të vitit shkollor 2019-20..

Viti mësimor përbëhet prej tri periudhave mësimore, periudha e parë e vitit mësimor ka filluar më 2 shtator 2019 dhe ka mbaruar me 27 dhjetor 2019, për këtë periudhë të procesit edukativo arsimor është raportuar në raportin vjetor të punës nga DA, 2019.

Periudha e dytë ka filluar me 13 janar 2020 dhe është dashur të mbaroj me 29 mars, kjo periudhë mësimore ka filluar mirë sipas kalendarit të vitit shkollor por për shkak të Pandemisë Covid-19, mësimi i rregullt është ndërpre me 11.03.2020 me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.01/07, duke pas parasysh ruajtjen e shëndetit të nxënësve dhe stafit të shkollave.

MASHT në një afat të shkurtër ka bërë përgatitjet për vazhdimin e mësimin në formë tjetër – online. Mësimin në distancë MASHT e ka filluar me transmetimin e orëve mësimore për disa lëndë në programin RTK, me datën 23.03.2020, më pastaj DA dhe Drejtorët e shkollave në bashkëpunim me mësimdhënësit kemi organizuar mësimin në distancë për të gjitha lëndët mësimore me platforma të ndryshme elektronike si : Zoom, Google meet , Viber etj.

Sfidat gjatë kësaj periudhe kanë qenë të ndryshme kryesisht rreth njohurive jo të mjaftueshme nga ana e nxënësve në përdorimin e teknologjisë – përdorimi i platformave të lartcekura dhe mungesa e paisjeve teknologjike duke përfshirë edhe mungesën e internetit në disa zona rurale.

DA-ja në bazë të mundësive të sajë si dhe me ndihmën nga ana e MASHT-it, kemi siguruar një numër të konsiderueshëm paisjeve teknologjike – Laptop për disa nxënës të cilët ekonomikisht familjet e nxënësve nuk qëndrojnë mirë.

Të gjitha aktivitetet jashtëshkollore si : Pikniku, shëtitje, ekskursionet me karakter arsimor dhe garat e diturisë në lëndë të ndryshme janë anuluar të gjitha për shkak të ruajtjes së shëndetit publik, po ashtu janë anuluar edhe matura dhe semimatura.

Sipas kalendarit të përshtatur për përfundimin e vitit shkollor 2019/20 në rrethanat e Pandemisë Covid-19, testi i arritshmërisë është dashur të mbahet me 23.06.2020 ndërsa testi i maturës është dashur të mbahet 04.07.2020. Mirëpo si rezultat i përhapjes së Pandemisë me përmasa të mëdha MASHT me vendimin nr.01-12 të datës 18.06.2020 ka vendosur ti shtyjë të dyja testet , testin arritshmërisë për datën 20.08.2020 dhe testin e maturës 29.08.2020.

Regjistrimi i nxënësve në klasën e parë dhe parafillor, është bërë duke zbatuar kalendarin e përshtatur për përfundimin e vitit shkollor 2019/20 në rrethanat e Pandemisë Covid-19, është organizuar dhe realizuar regjistrimi i nxënësve në klasën e parë në të gjitha shkollat fillore.

Regjistrimi i nxënësve në klasën e dhjetë, do të realizohet pas publikimeve të rezultateve të testit të arritshmërisë.

Kompensimi i obligimeve

Është bërë kompensimi i obligimeve sipas të gjitha kontratave kolektive, për mësimdhënësit e pensionuar, në aspektin e pagave jubilarë dhe pagave përcjellëse.

Trajnimet e mësimdhënësve ku në secilin grup kemi pasur nga 30 mësimdhënës:

- Ngritja e kapaciteteve të anëtareve të Ekipeve për Parandalimin dhe Reagimin ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit - EPRBM-ve.
- Plani Individual i Arsimit – PIA
- Programi i Orëve shtesë të gjuhës për fëmijët e riatdhesuar.

Projektet Kapitale të filluara dhe në proces të tenderimit:

- Ndërtimi i Kopshtit të fëmijëve në fshatin Mazgit i ulët, donacion nga Bashkimi Evropian.
- Ndërtimi i një salle të edukatës fizike, në SHFMU “Pandeli Sotiri” Obiliq i vjetër.
- Ndërtimi i aneksit në SHFMU”Naim Frashëri” Brezbinë.
- Ndërtimi i aneksit në SHFMU”Dr.Ibrahim Rugova”Paralelen e ndarë në fshatin Mazgit i Lartë .

- Blerje paisjeve për shkolla, inventar dhe pajisjet për sallat e edukatës fizike në SHFMU “ Hasan Prishtina” Milloshevë dhe SHMLP “Ismail Dumoshi”Obiliq .
- Renovimi i Objekteve shkollore

Suksesi i nxënësve në fund të gjysmëvjetorit të dytë 2019/20
 Arsimi fillor (1-5)

Komuna _____ OBILIQ

Klasa	Nr. paraleleve	Nr. nxënësve	Suksesi pozitiv										Numri i mungesave								
			Shkëlqyeshëm		Sh. mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Gjithsej me nota pozitive		Gjithsej me nota negative që përcillen		Të pa notuar		Të arsyeshme	Të paarsyeshme	Gjithsej		
			Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%			
1	19	324	239	73.77	65	20.06	14	4.32	6	1.85	324	100	0	0	0	0.00	1089	223	1312		
2	19	359	255	71.03	67	18.66	30	8.357	7	1.95	359	100	0	0	0	0.00	1595	126	1721		
3	19	328	208	63.41	57	17.38	40	12.2	22	6.71	327	99.7	1	0.30	0	0.00	1902	139	2041		
4	18	340	204	60	65	19.12	47	13.82	23	6.76	339	99.71	1	0.29	0	0.00	1400	158	1558		
5	19	398	194	48.74	91	22.86	53	13.32	60	15.08	398	100	0	0.00	0	0.00	1155	126	1281		
Gj	94	1749	1100	62.89	345	19.73	184	10.52	118	6.75	1747	99.89	2	0.11	0	0.00	7141	772	7913		

Suksesi i nxënësve në fund të gjysmëvjetorit të dytë 2019/20
 Arsini i mesëm i vitit (6-9)

Komuna _____ OBILIQ

Klasa	Nr. paraleleve	Nr. nxënësve	Suksesi pozitiv						Suksesi i pamjaftueshëm						Numri i mungesave												
			Shkëlqyeshëm		Sh. mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Gjithsej me nota pozitive		Përcillen në riprovim			Përsërisin klasën		Të pa notuar		Të arsyeshme	Të paarsyeshme	Gjithsej					
			Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%					
6	19	318	119	37.42	88	27.67	76	23.9	35	11.01	318	100	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2154	419	2573
7	19	353	115	32.58	93	26.35	95	26.91	50	14.16	353	100	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2359	460	2819
8	18	308	92	29.87	53	17.21	110	35.71	53	17.21	308	100	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2741	1047	3788
9	18	356	140	39.33	77	21.63	99	27.81	40	11.24	356	100	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2493	693	3186
GJ	74	1335	466	34.91	311	23.3	380	28.46	178	13.33	1335	100	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	9747	2619	12366

Suksesi i nxënësve në fund të gjysmëvjetorit të dytë 2018/19
 Arsini i mesëm i lartë (10-13)
 Komuna Obiliq

Klasa	Nr. paraleleve	Nr. nxënësve	Suksesi pozitiv						Suksesi i pamjaftueshëm			Numri i mungesave									
			Shkëlqyeshëm		Sh. mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Gjithsej me nota pozitive		Përcillen në riprovim		Përsërisin klasën	Të pa notuar		Të arsyeshme	Të paarsyeshme	Gjithsej	
Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr		%	Nr				%
10	10	241	31	12.86	34	14.11	108	44.81	53	21.99	226	93.78	15	6.22	0	-	0	-	1091	520	1611
11	12	231	34	14.72	32	13.85	79	34.20	59	25.54	204	88.31	6	2.60	21	9.09	0	-	795	536	1331
12	12	230	24	10.43	42	18.26	99	43.04	65	28.26	230	100.00	0	-	0	-	0	-	1013	575	1588
GJ	34	702	89	12.68	108	15.38	286	40.74	177	25.21	660	94.02	21	2.99	21	2.99	0	-	2899	1631	4530

RAPORTI I PUNËS - DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS

• Raporti i Punës Janar – Qershor 2020

Drejtoria e Infrastrukturës gjatë kësaj periudhe kohore ju kemi përgjigjur kërkesave të qytetarëve, kemi dërguar shkresa për institucione të ndryshme, kemi realizuar projekte dhe menaxhime të kontratave si për DIL ashtu edhe për drejtoritë tjera kërkuese të komunës. Kemi realizuar projekte për donatorë, marrëveshje me pronarë privat rreth investimeve kapitiale dhe përgatitja e dokumentacionit për evidentim në kadastrë, gjatë gjithë kohës staf i mbikqyrjes është marrur me zgjidhjen e problemeve në terren për impementimin sa më të mirë dhe në kohë të projekteve. Për me gjerësisht I gjeni të bashkangjitur tabelat e punëve të cilat janë duke u vazhduar nga kontratat e vitit të kaluar dhe ato të cilat janë shpallur dhe janë filluar të punohen.

PROJEKTET TË CILAT JANË PUNUAR NGA NDREJTORIA E DIL-it për drejtoritë komunale:

Për drejtinë e DIL-it

1. Hartimi I projekteve të rrugëve pjesa e pare ne Obilq
2. Hartimi I projekteve të rrugëve pjesa e dyte ne Obilq
3. Hartimi I projekteve të rrugëve pjesa e trete ne Obilq
4. Hartimi I kanalizimit fekal dhe atmodferik pjesa pare
5. Hartimi I projektit te Parkut ne Plemetne
5. Hartimi I projektit Mirembajtja e Objekte Komunale
6. Hartimi I projektit Fusha Sportit ne Obilq
7. Hartimi I projektit Blerja e paisjeve per shkolla

8. Hartimi I projektit te sheshit te Adem Preniqi
9. Hartimi I projektit te Biblioteles se Qytetit
10. Hartimi I projektit per Zonen Industriale ne Mazgit
11. Hartimi I projektit per QMF Breznice
12. Hartimi I projektit per renovimin e banesave Socile
13. Hartimi I projektit te shtepive Sociale
14. Hartimi I shtepive per Komunitete
15. Hartimi I salles se sportit
16. Kontrollimi I te gjitha paramasave dhe projeteve nga drejtorite tjera
17. Hartimi I projektit te Arhives
18. Peregaditja e projektit te koogjenerimit per tenderim
19. Hartimi I projektit per paisje sportive ne salla
20. Parku ne Mazgit Ferid Curri Renovim
21. Parku te sheshi Aziz Zhilivoda Obligiq
22. Renovimi I shkollave- Obligiq
23. Blerja e Invertarit per shkolla Obligiq
24. Shatorja e Adem Jasharit
25. Ndertimi I rrethojes se Sigurise ne vend punishte te sheshi Adem Preniqi
26. Ndertimi I nenstacionit te koogjenerimit
27. Projekti I Mullirit te Hysenajve ne fsh Grabovc

PROJEKTI TË CILAT JANË PROJEKTUAR TENDERUR NË VITIN 2019 DHE JANE DUKE U EKZEKUTUAR

Paramasa dhe Paralogaria për rrugët e Milloshevës Lazareve Bakshi dhe Raskovë

1. Rr. muzakaj L=447m B=4.2
2. Rr. Oso Kuka L=413m B=3.4
3. Rr. Raif Krasniqi segmenti 2 L=190m B=3.4
4. Rr. Raif Krasniqi segmenti 3 L=215m B=3.4
5. Rr. Gurëbardhi Seg 1 L=113m B=4
6. Rr. Gurëbardhi Seg 2 L=100m B=3.4
7. Rr. Gurëbardhi Seg 3 L=288m B=3.4
8. Rr. Gurëbardhi Seg 4 L=83m B=3.4
9. Rr. Idriz Seferi L=115m B=4
10. Rr. Ali Pasha L=371m B=4
11. Rr. Sefë Kosharja L=302 B=3.4
12. Rr. Ali Qerkezi, Vazhdimi kah Varrezat L=256m B=4
13. Raskovë Rr. Zahir Pajaziti seg1 L=60m B=3.5
14. Raskovë Rr. Zahir Pajaziti seg2 L=92m B=3.5
15. Rr. Dukati seg 1 L=93m B=3.0
16. Rr. Dukati seg 2 L=120m B=3.5

Rrugët e Obillogit Qendër dhe Obillog Nën hekurudhë

1. Obilq Rr: "Murat Krasniqi" L=150m Bmes=3.3m Zegjerimet S=18*4=72m ²
2. Obilq Rr: "Preshева" L=205m Bmes=3.5m Zegjerimet S=24*4=96m ²
3. Obilq Rr: "Ramë Tmava" L=200m Bmes=3.5m Zegjerimet S=16*4=64m ²
4. Obilq Kanalizimi Fekal Dhe Atmosferik në rrugën Anton Çeta
5. Obilq Rr: Anton Çeta - vazhdimi L=237m, B=4m Zegjerimet S=20*4=80m ²

Rrugët në Dardhishtë dhe Mazgit

1. Dardhishtë Rr. Ibrahim Gërguri L=254m, B=4m Zegjerimet S=8*4=32m ²
2. Dardhishtë Rr. Hazir Merlaku seg1 L= 95 m, B=3.5m + zgjjerimi 4x3=12m ²
3. Dardhishtë Rr. Hazir Merlaku seg2 L=225 m, B=3.5m + zgjjerimi 8x3=24m ²
4. Dardhishtë Rr. Ternava L= 147 m, B=3m + zgjjerimi 2x4=8m ²
5. Dardhishtë Rr. Adem Kutllovei L= 555 m, B=4m + zgjjerimi 22x4=88m ²
6. Mazgit Rr. Te Shkolla L= 70 m, B=3m + zgjjerimi 2x4=8m ²
7. Mazgit Rr. Halit Bici seg1 L= 113 m, B=3m + zgjjerimi 2x4=8m ²
8. Mazgit Rr. Dita e Flamurit seg1 L= 85 m, B=3m + zgjjerimi 2x4=8m ²
9. Mazgit Rr. Kadri Raqi L= 170 m, B=4m + zgjjerimi 4x4=16m ²
10. Mazgit Rr. Dita e Flamurit seg10 L= 150 m, B=4m + zgjjerimi 2x4=8m ²
11. Mazgit Rr. Hysen Raqi L= 128 m, B=4m + zgjjerimi 4x4=8m ²
12. Mazgit Rr. Hasan Prishina seg1 L= 115 m, B=3m + zgjjerimi 2x4=8m ²
13. Mazgit Rr. Vagë Zela L= 189 m, B=5m + zgjjerimi 16x5=80m ²
14. Mazgit Rr. Kruja L= 180 m, B=4m + zgjjerimi 6x4=24m ²

15. Mazgit Rr. Pajtimi L= 285 m , B=4m + zgjerimi 8x4=32m ²
16. Mazgit Rr. Pajtimi seg1 L= 127 m , B=4m + zgjerimi 8x4=32m ²
17. Mazgit Rr. Dita e Flamurit seg5 L= 122m , B=3m + zgjerimi 2x4=8m ²
18. Mazgit Rr. 17 Shkurti L= 404 m , B=4m + zgjerimi 14x4=56m ²
19. Mazgit Rr. 17 Shkurti seg1 L= 62 m , B=3m + zgjerimi 2x4=8m ²
20. Mazgit Rr. Liria L= 238 m , B=4m + zgjerimi 4x4=16m ²
21. Mazgit Rr. Qëndresa L= 286 m , B=4m + zgjerimi 4x4=16m ²
22. Mazgit Rr. Lëndina L= 233 m , B=3m + zgjerimi 4x4=16m ²
23. Mazgit Rr. Dita e Flamurit seg9 L= 97 m , B=3m + zgjerimi 2x4=8m ²

RROJËKTET DUKE U EKZEKUTUAR NGA VITI 2019

1. Rregullimi I parkut 17 Shkurti Mazgit dhe Parku ne Palaj
2.Rregullimi I parkut Mazgit I Larte
3. Asfaltimi I rr. Se Unazes të Qyteit dhe seg I rr. Vashingtoni

Projektet e rrugëve me kubëza te citat janë dorzuar në prokurim dhe janë lidhur kontratat për vitin 2020 janë:

1	Obilq Rr. Idriz Sallova seg 2 L= 115 m , B=4m
2	Obilq Rr. Idriz Sallova seg 1 L= 40 m , B=4m
3	Obilq Rr. Dëshmorët e Sibovcit seg 1 L= 71 m , B=3.5m
4	Obilq Rr. Dëshmorët e Sibovcit seg 2 L= 55 m , B=3.5m

5	Obilq	Rr. Dëshmorët e Sibovcit seg 3	L= 50 m, B=4.0m
6	Obilq	Rr. Hasan Prishtina seg 1	L= 125 m, B=4.0m
7	Obilq	Rr. Ukshin Hoti seg1	L= 70 m, B=3.0m
8	Obilq	Rr Daut Hashani seg 1	L= 66m, B=3.7m
9	Obilq	Rr Avdullah Qerkezi seg 1	L= 55m, B=4m
10	Obilq	Rr Avdullah Qerkezi seg 2	L=88m, B=3.5m
11	Obilq	Rr Avdullah Qerkezi seg 3	L=75m, B=4m
12	Obilq	Rr Avdullah Qerkezi seg 4	L=92m, B=4m
13	Obilq	Rr Avdullah Qerkezi seg 5	L=90m, B=4m
14	Obilq	Rr Avdullah Qerkezi seg 6	L=88m, B=3m
15	Obilq	Rr Avdullah Qerkezi seg 7	L=75m, B=3m
16	Obilq	Rr Abdurrahmon Gërguri seg 1	L=30m, B=4m
17	Obilq	Rr Hasan Prishtina seg 2	L=65m, B=3.5m
18	Obilq	Kanalizimi fekal në rrugën Hasan Prishtina Segmenti 1	
19	Obilq	Kanalizimi fekal në Rr.Abdullah Qerkezi Segmenti 6	
20	Obilq	Kanalizimi fekal në Rr.Abdullah Qerkezi Segmenti 7	
21	Obilq	Rr Fejzullah Graçevci seg 1	L=15m, B=4m
22	Obilq	Rr Fejzullah Graçevci seg 2	L=80m, B=4m
23	Obilq	Rr.Adem Jashari dhe Kanalizimi	
24	Lazarev	Rr. Te Xhamia dhe Shetitorja	
25	Parkingu	në QKMF-Obilq	

Projektet e rrugëve me Asfalt të citat janë dorzuar në prokurim dhe janë lidhur kontratat për vitin 2020 janë:

1	Obilq	Rr. Avdyl Frashëri	L= 140 m, B=3m
2	Obilq	Rr. Ijaz Hashani seg 1	L= 61 m, B=3m
3	Obilq	Rr. Ijaz Hashani seg 2	L= 60 m, B=3m
4	Obilq	Rr. Ijaz Hashani seg 3	L= 80 m, B=3m
5	Obilq	Rr. Ijaz Hashani seg 4	L= 87 m, B=3m

6	Obiliq Rr. Te Parku L= 200 m, B=4m
7	Obiliq Rr. Llapii seg 1 L= 215m, B=3m
8	Obiliq Rr. Tropoja L= 310 m, B=4m
9	Obiliq Nuhi Kelmendi Seg 1 L= 105 m, B=3m
10	Obiliq Liburnia L= 251 m, B=4m
13	Obiliq Rr Fejzullah Grajçevci seg 3 L=84m, B=3m
14	Obiliq Rr Fejzullah Grajçevci seg 4 L=80m, B=3m
15	Obiliq Rr Fejzullah Grajçevci seg 5 L=80m, B=3m
16	Obiliq Rr Fejzullah Grajçevci seg 6 L=135m, B=4m
17	Obiliq Rr Fejzullah Grajçevci seg 7 L=35m, B=3m
18	Obiliq Rr Fejzullah Grajçevci seg 8 L=70m, B=3m
19	Obiliq Rr Fejzullah Grajçevci seg 9 L=20m, B=3m
20	Obiliq Rr Fejzullah Grajçevci seg 10 L=20m, B=3m
21	Obiliq Rr Fejzullah Grajçevci seg 11 L=380m, B=3m
22	Obiliq Rr Hasan Prishtina seg 3 L=100m, B=3m
23	Obiliq Rr. Rozafa L= 230 m, B=3m
24	Obiliq Rr Pashko Vasa L=115m, B=3m DHE KANALIZIMI FEKAL
25	Obiliq Rr Haxhi Zeka L=195m, B=3m
26	Obiliq Rr. Llapii seg 2 L= 40 m, B=3m
27	Obiliq Rr Janina seg 1 L=190m, B=4m
28	Obiliq Rr. Faik Konica L= 190 m, B=4.0m
29	Obiliq Rr. Albert Rama L= 245 m, B=4.0m
30	Obiliq Rr. Isa Boletini L= 75 m, B=4.0m

Projektit e rrugëve me Asfalt te cilat janë dorzuar në prokurim për vitin 2020 janë:

1	Obiliq Rr. Kuvendi I Arbërit seg 1 L= 35 m, L1=20m, B=6m; l2=15m, B3m
2	Obiliq Rr. Kuvendi I Arbërit seg 2 L= 55 m, B=3m
3	Obiliq Rr. Mustaf Kastrioti L= 130 m, B=3.5m
4	Plemetin Rr. Faruk Ibrahimini L= 403 m, dhe Parkingu te Xhamia B=9m

5	Asfaltimi rrugës kryesore pjesa e (Shpocit)
6	Renovimi i rrugës kryesore pjesa e (Shipitullës)
7	Siboc Rr Beregeti L=665m , B=3.0m
8	OBILIQ I VJETER RREGULLIMI I UJIT DHE KANALIZIMIT FEKAL NË RRUGËN MUSTAF KASTRATI
9	PLEMETIN KANALIZIMI FEKAL TE BANESAT E PLEMETINIT
10	SIBOVC RREGULLIMI I GYPIT TE UJIT DHE I KANALIZIMIT FEKAL
11	SHIPITULL PUNIMI I KANALIZIMIT ATMOSFERIK ME GYPA BETONI Ø1000mm

REKAPITULLIMI I PËRGJITSHËM		
I	Dardhishhtë Kanalizimi fekal Prej Beni Com te Hirri	12,618.67 €
II	Dardhishhtë Kanalizimi Fekal Prej Hekurudhës deri te Kanal Profiks	6,940.26 €
III	Lazarevë Kanalizimi Fekal në lagjen Kikoli	2,411.39 €
IV	Dardhishhtë Kanalizimi fekal në lagjen Gjigoli	2,443.89 €
V	Obilq Kanalizimi fekal te Behar Hashani (Sera)	859.98 €
VI	Plemetin Kanalizimi fekal	614.25 €
VII	Obilq Kanalizimi fekal në Rr. Idriz Solova (Berbatovci)	2,326.38 €
VIII	Obilq Kanalizimi fekal seg.i Rr.Mbretresha Teut	1,538.38 €
IX	Lajthishhtë Kanalizimi fekal (Arif Dedinca)	757.63 €
TOTALI PËRGJITSHËM		30,510.82 €

RAPORTI I PUNËS – DREJTORIA E SHËNDEFTËSIS DHE MIRQENIES SOCIALE

• Raporti i Punës Janar – Qershor 2020

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale gjatë muajve janar-qershor 2020 në kuadër të përgjegjësiive të veta ka kryer punë dhe detyra të shumta duke përfshi edhe menaxhimin me situatatën e krijuar nga Pandemia COVID 19.

Gjatë kësaj periudhe janë kryer punë tekniko dhe administrative:

- Me "CaritasKosova" kemi lidh marrëveshje për blerjen e shërbimeve shëndetësore për programin "Ngritja e përkujdesit shtëpiak dhe ambulantor".
 - Kujdesi Shëndetësor i Qasshëm dhe Cilësor projekti është në vitin e pestë duke u implementuar dhe ne si Komunitë jemi në mesin e dymbëdhjetë Komunave të përzgjedhura nga kjo OJQ. Projekti implementohet nga Seiss TPH and Save the Children dhe përfritimet nga ky bashkëpunim janë të shumëfisha si: ngritja e kapaciteteve njerëzore në ofrimin e shërbimit cilësor shëndetësorë.
 - Janë lidhë marrëveshje në mes Kryetarit të Komunës z.Xhafer Gashi dhe Organizatës Ndërkombëtare Humanitare- Arbeiter-Samariter-Bund Deutschland më 11.03.2020. Projekti është financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme Gjermane dhe implementohet nga Organizata Humanitare Gjermane "Arbeiter-Samariter-Bund Deutschland e.V. (ASB) në Kosovë. Qëllimi I këtijë projekti është të mbështesë familjet në nevojë të Komunës për krijimin e kushteve më të mira për filimin e biznesit të vogël familjar.
 - Memorandum bashkëpunimi i nënshkruar më 12.03.2020 nga Kryetari i Komunës z.Xhafer Gashi dhe Organizatën Kuëait Society for Relief & Duar e Bamnisë. Në kuadër të këtijë memorandumimi më 18.05.2020 u bë vënia e gurtëhemelit për ndërtimin e AMF-së në fshatin Breznicë, vlera e projektit është 77,000.00€.
 - Kemi realizu takime të shumta, i fundit ishte më 01.07.2020 MSH, IKSHP, OBSH dhe janë bërë kërkesa për formimin e komisionit të përbërë nga ekspert shëndetësorë për të na ndihmuar në nxerjen e akteve nënligjore, në hartimin e Politikave shëndetësore të veqanta konform ligjit specific për zonën e rrezikuar mjedisore të Oblitqit.
 - QKMF-ja është përfritues i një autoambulance të cilën e kemi donacion nga një bashkëardhetar i yni i cili jeton në Suedi.
- Drejtorja për Mirëqenie Sociale dhe Shëndetësi pas shfaqjes së Corona virusit si Pandemi Globale dhe pas marrjes së masave adekuate nga Qeveria e Kosovës dhe implementimit nga Komunitat personeli shëndetësorë kanë luajtur një rol të rëndësishëm në kordinimin dhe zhvillimin e aktiviteteve kundër përhapjes së virusit CORONA. Komuna dhe QKMF-ë duke qenë vija e parë e ofrimit të shërbimeve, duke pasë parasysh kapacitetin dhe buqjetin komunal, përballjen me sfida të shumta kemi arrit të menaxhojmë në mënyrën më të mirë të mundshme.
- Me datë 22.02.2020 Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, ka kërkuar nga të gjithë drejtorët të institucioneve shëndetësore në Republikën e

Kosovës në mënyrë urgjente të sigurojnë:

1. Identifikimin e objektit për karantinë të grupeve, pacienteve që janë të dyshimt me Corona Virus, me qëllim të mos përziejës me pacientë të tjerë.
2. Sigurimi i paisjeve mbrojtëse për puntorët shëndetësorë të QKMF-ve.
3. Sigurimi i një e më shumë termometrave me reze infra të kuqe.
4. Të gjitha QKMF-të të përditësojnë të dhënat dhe të raportojnë në detaje për të gjitha masat e ndërmarra.

Më 23.02.2020 Ministria e Shëndetësisë dhe IKSHP ka kërkuar me prioritet nga Komunitat të caktojnë ekipe 24 orëshe të cilat nga data 24.02.2020 të bëjnë matjen e temperaturës të gjithë qytetarëve që kërkojnë shërbime shëndetësore në QKMF. Pashu është kërkuar që të caktohen ekipe mbështetëse në pikat kufitare, ku do të kontrollohen të gjithë pasagjeret në hyrje të kyfinjëve tokësorë të Kosovës për shenja klinike të Corona Virusit.

Duke u mbështet në rekomandimet dhe detyrat e dalura nga IKSHP dhe MSH, që nga data 24.02.2020, DSHMS së bashkum me QKMF-ën, ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme ku siguroi:

1. 3 termometra me reze infra t'kuqe
2. maska, doreza dhe dezinfektues.
3. Identifikimi i objektit për ekzaminim të pacientëve të dyshimt- Njësia e Urgjencës caktohet si portë hyrëse për pacientët e dyshuar me Corona Virus.
4. Veshmbathje komplet me syza mbrojtëse (të cilat komuna jonë i ka poseduar qysh moti dhe kemi genë të gatshëm për të ndihmuar edhe komunitat të cilat kanë pasur nevojë si; Lipjani, Drenasin, Prishtinë, Vitinë, Ferizajin dhe Pejë).
5. Jan formuar katër ekipet për monitorimin e situatës
6. Është ngrit niveli i higjienës dhe masava tjera në bazë rekomandimeve të IKSHP-së : Dezinfektimi i QKMF-së dhe autoambulancave në baza ditore.
7. Është njoftuar personeli me masa të cilat duhet të ndërmerren në parandalimin e infeksionit me Corona Virus.

8. Kemi vendosur njoftues, udhëzues mbi njohuritë për virusin në të gjitha Shkollat, Ambullanta, Shtëpi të Plegëve, Qendër për Punë Sociale, Qendra Rinore, Salla Sportive, Shtëpi të Kulturës, Qendrën për Punsim, Komunën etj.
 9. Stafit administrativ dhe teknik është angazhuar me punë të tjera si: staf mbështetës për ekipe shëndetësore, vozitës etj.
 10. Janë dedikuar autoambulanca dhe vetura vetëm për raste të dyshuara me virusin Corona.
 11. Kemi siguruar ekipe mbështetëse në Aeroportin e Prishtinës "ADEM JASHARI", të paisur me veshmbathje komplete dhe termometra, ndërsa Kryetari i Komunës siguroi mbështetje logjistike për këto ekipe (pajset, veturën, ushqimin).
 12. Kemi paisur me mjete mbrojtëse të gjithë pacientët e Hemodializës.
 13. Kemi ndërprer të gjitha pushimet vjetore për puntorët shëndetësorë, për shkak të situatës me COV19.
- Duke pas parasysh situatën epidemiologjike e cila merretë përmasa më të mëdha si dhe fluksin e madhë të udhëtarëve të kthyer nga vatrata epidemike më 08.03.2020 nga MSH rekomandohet të dyfishohen ekipet e QKMF-ve në hyrjet kufitare të Kosovës, si dhe personat që vinë nga vatrata epidemiologjike të vetëkarrantinohen. Me këtë rast dyfishohen ekipet tona në Aeroport të Prishtinës gjithsej formohen tri ekipe mbështetëse nga Komuna e Obiliqit.
- Më datë 03.03.2020 në bashkëpunim me MPMS- Departamentin e ndihmave Sociale në Prishtinë u shpërndanë 70 pako me veshmbathje për familjet në varfëri të skajshme në bashkëpunim me puntorët e Qendrës Punë Sociale.
- Me qëllim të menaxhimit të situatës dhe rezikut të mundshëm nga Corona Virusi më 11.03.2020, në Komunën e Obiliqit mbyllet përkohësisht "Shtëpia e Plegëve" si rezultat i rrezikshmërisë në të lartë që të moshuarit të atakohen nga Virusi Korona. Pas mbylljes së aktiviteve në "Shtëpinë së Plegëve" ky objekt cakrohet si karantinë për rastet e infektuara me COVID-19.
- Nga Ministria e Shëndetësisë më 12.03.2020, jemi paisur me 80 veshmbathje dhe 5 termometra me reze infra të kuqe.
 - Kemi formuar ekipe mobile që punojnë 12 orë, të paisura me mjete mbrojtëse për egzaminimin të pacientëve të dyshimt.
 - Me datën 13.03.2020 është formuar Shtabi Komunal Emergjent për kordinimin e aktiviteve për parandalimin e COVID-19 në Komunën e Obiliqit
 - Me datën 14.03.2020 nga donator të ndryshëm, siguruam 400maska dhe 2 termometra me reze infra të kuqe.
 - Me datën 15.03.2020 me kërkesë të MSH u dërgu një ekip shëndetësor në mbështetje të kufirit në Elez Han. Ekipa shëndetësore nga Komuna

- e Obiligtit ekzaminoni mbi 100 të ardhur nga vatrata epidemiologjike.
- Më kërkesë të Ministrisë së Shëndetësisë, më 15.03.2020 Qeveria merr vendim me nr.01/11 të shpallë gjendje të emergjencës për shëndetin publik.
- Me datën 15.03.2020 nga Policia jemi njoftu për një të ardhur, shtetase italiane nga Venecia e punsuar në biznesin XX, të Komunës sonë. Ekipa shëndetësore takon menjëher shtetasen italiane të cilës i bën ekzaminimin për shenjat e COVID-19. E ardhura gjatë gjithë kohës kishte mbajtur maskë dhe doreza e cila nuk kishte shenja të virusit. I kemi dhanë të gjitha rekomandimet e duhura, vetizolim në banesën të cilën jetonte, nënshkrimin e deklaratës se nuk do thotë asnjë rekomandim as detyrë të vetëizolimit dhënë nga IKSHP-ja, numrin e telefonit.
- Nga banorët e Komunës jemi njoftuar se me datën 15.03.2020 se personi XX kishte ardhur nga Bolzano e Italisë, gjendja shëndetësore e të ardhurit ishte e qetë dhe stabile, nuk kishte shenja të virusit COVID-19. I rekomanduam qëndrim në shtëpi deri në 14 ditë, me të cilin kemi kontaktuar çdo ditë dhe e kemi rekomanduar në vazhdimsi.
- Me datën 15.03.2020, kemi dërguar një termometër me reze infra të kuqe Stacionit të Policisë
- Me datën 16.03.2020, morëm informacion për një të ardhur nga Milano. Ekipa e QKMF-së vizitoi menjëherë familjen për egzaminimin e shenjave të virusit COV 19. Familjes ju dhanë të gjitha rekomandimet dhe e udhëzuan për vetë izolim. Me të gjitha familjet të vetëizoluar në baza ditore ka komunikim Epidemiologjia e QKMF-Obilja. Çdo ditë nga familjet janë marrë të dhëna për gjendjen e tyre shëndetësore dhe ju janë përserit rekomandimet dhe përgjegjësitë e vetë izolimit në mënyrë që të shmangët përhapja e virusit COVID 19.
- Me datën 16.03.2020, furnizuan zyrtarët komunal dhe inspektorët me mjete mbrojtëse si: Dorëza, Maska dhe termometër me reze infra të kuqe.
- Me datën 16.03.2020, u furnizuan nga depo qëndrore e MSH me material mbrojtës si: 300 Maska dhe 4000 Doreza.
- Me datën 16.03.2020 dhe 17.03.2020 Epidemiologu së bashku me drejtorin e QKMF-së vizituan të gjitha qendrat e shërbimeve shëndetësore duke vëzhguar zbatimin e rekomandimeve dhe detyrave në lidhje me parandalimin e infeksionit me Covid-19.
- Me datën 17.03.2020, kontaktuam me të gjithë Kryetarët e Këshillave të fshatrave dhe lagjeve për të verifikuar nëse ka të ardhur nga vendet e prekura me Covid-19.
- Me datën 17.03.2020, furnizohet me material mbrojtës zyrtarët komunal dhe inspeksioni.
- Me datën 17.03.2020 në ora 11:00, u takuam me Kolegjinimin e Shëndetësisë në Prishtinë, të gjithë drejtorët e DSHMS-ve paraqitën kërkesat urgjente si:

1. Kërkesë për furnizim me material mbrojtës në mënyrë urgjente
 2. Komunikim në baza ditore me nivelin qëndrorë
 3. Kërkesë për furnizim me pako ushqimore për rastet sociale, rastet e izoluarra në karantinë dhe ekipet kufitare.
- Me datën 17.03.2020, u vendos tenda në QKMF me qëllim të egzaminimit të rasteve të dyshuara me Covid-19.
 - Me datën 17.03.2020, ekipa e QKMF-së dërgohet të mbështesë Hanin e Elezit, gjatë 12 orëve punë janë kontrolluar 150 persona të hyrë në Kosovë.
 - Me datën 18.03.2020 ekipa Shëndetësore kontaktoi çiftin e prekur me Covid-19 ku edhe ndihnuan me ushqim si dhe pako higjienike, ju përsëritën rekomandimet e vetizolimit. Qifti i rezultuar pozitiv me COVID 19 deklaruan se janë mirë dhe nuk po i thejnë rregullat e vetë izolimit.
 - Me datën 19.03.2020 vizituan banesat kolektive në Plemetin, ku biseduam me përfaqesin e tyre. Gjendja shëndetësore e tyre ishte e mirë dhe nuk kishte të ardhur nga vendet e tjera, pastaj vizituan ambulancën e Plemetit ku doktori deklaroi se gjendja ishte e qetë dhe stabile, nuk ka të dyshuar apo të ardhur nga vendet e prekura me Covid-19.
 - Me datën 19.03.2020 Bashkësia Islame bëri shpërndarjen e pakove higjienike në Plemetin, ata ndihnuan 60 familje në banesat kolektive në Plemetin, në lagjen Markovac- 10 familje, Obliça- 9 familje, si dhe familje te ndryshme në Mazgri, Breznice, Milloshëve dhe Kozaricë, gjithësej u ndihnuan 150 familje me mjete higjienike.
 - Me datën 19.03.2020 dy banorë nga Obiliqit me simptoma dyshimi dhe ju rekomandohen vetizolim 14 ditë. Personat janë kontaktuar në baza ditore nga epidemiologjia e QKMF.
 - Me datën 20.03.2020, ekipa e QKMF-së ishte në Aeroportin Adem Jashari për të kontrollu edhe 100 të ardhur nga Gjermania.
 - Me datën 20.03.2020 një e dyshuar me shenja të Covid-19 u dërgua në Klinikën Infektive për analiz, pas egzaminimit rekomandohet për vetizolim.
 - Me datën 20.03.2020 dy raste dërgohen nga ekipa e QKMF-së Obiliq në Klinikën Infektive si raste të dyshuara me Covid-19. Të dy familjet pas egzaminimit shkojnë në vetëizolim.

Të gjitha familjet e vetëizoluara janë kontaktuar në baza ditore nga Epidemiologjia jonë. Janë rekomanduar për masat e vetëizolimit si dhe ju janë përsërit masat mbrojtëse të cilat duhen të ju përmbahen po ashtu të kërkojnë në mënyrë urgjente ndihmë mjekësore nëse kanë ndonjë shqetësim

apo përkeqsim të gjendjes shëndetësore. Po ashtu që nga rasti i parë i paraqitur pozitiv me COVID 19 është ofru mbështetje logjistike për të gjitha familjet e vetizoluara nga Kryetari i Komunës së Obiliqit.

Me datën 21.03. 2020 është kryer Dezinfektimi në Komunën e Obiliqit në këto objekte:

Dezinfektimi në Objektet e Institucioneve Komunale, Shkollore , Shëndetësore, Fetare, publike dhe Kulturore Sportive

NR	Objektet e Dizinfektuara në Komunën e Obiliqit	Data	Sipërfaqja
1	Ekipa e Parë		
2	Objekti I Komunës - QKRC	21.03.2020	
3	Gjinnazi "17 Shkurt"	21.03.2020	
4	SHM Teknike " Ismail Dumoshi"	21.03.2020	
5	Institucioni Parashkollorë	21.03.2020	
5	SHFMU " Ibrahim Rugova" Obilig	21.03.2020	
7	SHFMU " Ibrahim Rugova" Mazgit I Ujt	21.03.2020	
3	SHFMU "Ibrahim Rugova" Mazgit I lart	21.03.2020	
9	SHFMU " Pandeli Sotiri" Obilig I Vjetër	21.03.2020	
10	SHFMU "Hasan Prishtina" Milloshevë	21.03.2020	
